



## **LIGJ Nr. 119/2014 PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT (I ndryshuar me ligjin nr.78, datë 21.09.2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”)**

### **Neni 11**

#### **Kërkesa për informim**

1. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji.
2. Në çdo rast, kërkesa për informim regjistrohet dhe për të caktohet një numër rendor. Numri rendor, së bashku me të dhënat e kontaktit të koordinatorit për të drejtën e informimit, i jepet kërkuarit që ka bërë kërkesën për informim.
3. Kërkesat për informim regjistrohen sipas radhës së paraqitjes dhe trajtohen pa dallime mes tyre.
4. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:
  - a) emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
  - b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
  - c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;
  - ç) formatin në të cilin preferohet informacioni;
  - d) çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.
5. Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.



## Neni 15

### Afati për marrjen e informacionit

(ndryshuar togfjalëshi në pikën 5, me ligjin nr.78, datë 21.9.2023)

1. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.
2. Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë.
3. Afati i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtme:
  - a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;
  - b) nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;
  - c) nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës. Vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuarit.
4. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim.
5. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të ruajtur në arkivat në veprim.

### **Ligji Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për Auditimin Ligjor, Organizimin E Profesionit Të Audituesit Ligjor Dhe Të Kontabilistit Të Miratuar”, i ndryshuar**

Neni 57/1 E drejta e ankimit

Kundër vendimit të Bordit të Mbikëqyrjes Publike, audituesi ligjor ose shoqëria e auditimit mund të bëjë ankim në gjykatën administrative kompetente, brenda 45 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

**Rregullore nr. 4, datë 29.03.2018 “Për investigimin dhe procedurat e marrjen e masave disiplinore”, e ndryshuar**

Neni 11

Marrja e informacionit, depozitimi dhe forma e tij

1. Ankesat e ardhura pranë BMP duhet të jenë në formë të shkruar dhe duhet të përmbajnë të dhëna të rëndësishme për fakte dhe rrethana të ekzistencës së një sjelljeje të keqe apo papajtueshmërie, mbi të cilën mund të gjykohet për kryerjen e nje procesi investigimi.
2. Ankesa duhet të përmbajë minimalisht këto elemente:
  - a. Të dhëna mbi ankuesin, të identifikuar në mënyrë të qartë;
  - b. Të dhëna mbi subjektin e mbikqyrjes objekt i ankesës;
  - c. Përshkrimin e shkeljeve të supozuara apo rrethanave konkrete të pretenduara dhe kohën e ndodhjes së tyre;
  - ç. Dokumentet apo burimet mbështetëse të atyre fakteve apo rrethanave të pretenduara;